



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit  
SJ-003  
Prishtinë, më 10 shtator dhe 2 tetor 2017

**P R O C E S V E R B A L**

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 10 SHTATOR DHE 2 TETOR 2017**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të 53 deputetëve të Kuvendit.

**1. Debat parlamentar lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për debat parlamentar që ta marrë fjalën.

Deputeti Albin Kurti, në emër të parashtruesit të kërkesës për debat parlamentar, tha se nga ato pak faqe që i keni quajtur ‘Parime programore’ nuk jam fare optimist. Janë tejet të përgjithshme, prandaj përgjithësisht bosh, si listë dëshirash. Përrjashtim bën vetëm shpallja se bartës i zhvillimit ekonomik do të jetë kapitali privat, që e bën të duket program i djathtë,

por nuk tregon se si do të vijë ky kapital privat kaq befasisht, kur dihet se vendet e rajonit nuk kanë bërë ndonjë mrekulli kohët e fundit në investimet e huaja direkte.

Thoni se do të çoni shumë para në bujqësi, shumë para në arsim, shumë në shëndetësi, shumë për rininë, shumë për policinë, shumë për ushtrinë, si dhe shumë para për politika sociale që ofrojnë një jetë të dinjitetshme për të gjithë ata që nuk kanë mundësi objektive të punojnë. Nga njëra anë, kjo tregon paaftësi për të ofruar prioritete, si dhe paaftësi për të ndërtuar një program konkret.

Nga ana tjetër, thoni se nuk do t'i rrisni taksat, por do ta rritni buxhetin nëpërmjet rritjes ekonomike. Kjo do të thotë se premtimet për shumë para janë tërësisht të pambuluara nga buxheti, ndërkohë që nuk parashihet asnjë instrument i ri financiar që ndihmon ekonominë.

Ne e dimë se nga kjo Qeveri nuk ka dobi, por unë ju lus, mos na bëni dëme, para se të vijë qeveria jonë. Diskutimi i plotë i deputetit Kurti është dhënë në transkript.

Lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021 diskutuan këta deputetë: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Milaim Zeka dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Meqë anëtarët e kabinetit qeveritar nuk ishin të pranishëm në seancë, kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, propozoi që seanca t'i ndërpresë punimet për të vazhduar të martën, në orën 12:00, në të cilën duhet të jetë e pranishme edhe Qeveria e Kosovës.

Kryetari e ndërpreu seancën në orën 13:05 minuta, ndërsa për vazhdimin e saj vendos Kryesia e Kuvendit.

\* \* \*

*E hënë, më 2 tetor 2017, ora 10:00*

*Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 10 shtator 2017*

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari konstatoi se në sallë ishin të pranishëm 59 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme.

Në fillim kryetari i njoftoi të pranishmit me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetëve, të cilët ishin zgjedhur anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në vijim:

1. Deputeti Nait Hasani, kandidat i koalicionit “PDK, AAK, NISMA, PD, LB, PSHDK, PKK, ADK, RK, PB, PS, BKK”, e zëvendëson Ramush Haradinajn, i cili është zgjedhur Kryeministër i Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017.
2. Deputeti Bekë Berisha, kandidat i koalicionit “PDK, AAK, NISMA, PD, LB, PSHDK, PKK, ADK, RK, PB, PS, BKK”, e zëvendëson Pal Lekajn, i cili është anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 9 shtator 2017.
3. Deputeti Gani Dreshaj, kandidat i koalicionit “PDK, AAK, NISMA, PD, LB, PSHDK, PKK, ADK, RK, PB, PS, BKK”, e zëvendëson Rrustem Berishën, i cili është anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 9 shtator 2017.
4. Deputeti Enver Hoti, kandidat i koalicionit “PDK, AAK, NISMA, PD, LB, PSHDK, PKK, ADK, RK, PB, PS, BKK”, e zëvendëson Enver Hoxhajn, i cili është anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 9 shtator 2017.
5. Deputeti Fadil Beka, kandidat i koalicionit “PDK, AAK, NISMA, PD, LB, PSHDK, PKK, ADK, RK, PB, PS, BKK”, e zëvendëson Fatmir Limajn, i cili është anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 9 shtator 2017.
6. Deputeti Imet Rrahmani, kandidat i koalicionit “LDK, AKR”, e zëvendëson Behgjet Pacollin, i cili është anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 9 shtator 2017.
7. Deputeti Bahrim Shabani, kandidat i subjektit politik “Koalicija VAKAT”, e zëvendëson Rasim Demirin, i cili është anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 9 shtator 2017.

Kryetari i ftoi deputetët e rinj që ta japin betimin dhe ta nënshkruajnë deklaratën e betimit. Deputetët e lartshënuar e dhanë betimin dhe e nënshkruan deklaratën e betimit.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

### **1. Debat parlamentar lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021**

Kryetari i njoftoi deputetët se në seancën e jashtëzakonshme të filluar më 10 shtator 2017, për Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021 kanë diskutuar: Albin Kurti në përfaqësim të grupit të deputetëve nënshkruar; Avdullah Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së, si dhe deputetët Milaim Zeka e Arben Gashi.

Pastaj, kryetari e hapi debatin lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021.

Lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021 diskutuan: Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar të “Nismës për Kosovën” dhe Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas, kryetari e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta marrë fjalën.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se Kuvendi ka votuar që të mos debatohet për parimet programore, prandaj e konsideron këtë çështje të mbyllur. Qeveria e Kosovës e ka proceduar Programin qeverisës 2017-2021 në Kuvend dhe kurdo që Kuvendi vendos për të diskutuar, do të jetë i gatshëm ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë program para deputetëve të Kuvendit.

Pastaj kryeministri, së bashku me Kabinetin qeveritar, e lëshuan sallën e seancës plenare.

Në vazhdim, lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021 diskutuan këta deputetë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Driton Selmanaj, Dardan Sejdiu, Blerim Kuçi, Milaim Zeka, Bekim Haxhiu, Mytaher Haskuka, Kujtim Shala, Shkumbin Demaliaj, Albulena Reshitaj, Faton Topalli, Lumir Abdixhiku, Hajdar Beqa, Time Kadrijaj, Sami Kurteshi, Hykmete Bajrami, Ganimete Musliu, Dardan Molliqaj, Armend Zemaj, Slobodan Petroviq, Salih Salihu, Naser Rugova, Xhelal Sveçla, Korab Sejdiu, Sala Berisha-Shala, Teuta Haxhiu, Shqipe Pantina, Ilir Deda, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Ismail Kurteshi, Haxhi Avdyli, Arbërie Nagavci, Fidan Rekalii, Rasim Selmanaj dhe Fitore Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi i njoftoi deputetët për zëvendësimin e deputetit Rustem Berisha, i cili është emëruar ministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me deputetin Gani Dreshaj, i cili e dha betimin dhe e nënshkroi deklaratën e betimit.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 18:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*